



Republika e Kosovës - Republika Kosova
Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborna komisija za žalbe i molbe

A nr. 188/2010

Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (KZAP), në panelin e përbërë nga Muharrem Shala, kryesues, Ymer Hoxha dhe Sali Toplica, anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Zyrës për Regjistrimin e Partive Politike dhe Certifikim (ZRPPC) të Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ), paraqitur kundër subjekti politik, Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, për mos deklarimin e Raportit Financiar, për Rundin e Dytë (II) të Zgjedhjeve të Jashtëzakonshme në Komunën e Istogut, që parashihet në bazë të dispozitave ligjore të neneve 40.1 dhe 119.2 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (LZP), si dhe në bazë të nenit 6.6 të Rregullës Zgjedhor nr. 12/2009, në seancën e panelit të mbajtur me 16 Korrik 2010, mori këtë:

V E N D I M

Ankesa pranohet si e bazuar.

Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dënohet me gjobë prej 6000 (gjashtë mijë) euro, të cilën shumë është e detyruar që të paguajë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi, për tu dërguar pastaj në buxhetin e konsoliduar të Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M I

KZAP më 22.06.2010, ka pranuar një ankesë nga ZRPPC-ja, në të cilën theksohet se subjekti politik PDK nuk e ka dorëzuar Raportin e Deklarimit Financiar, për Rundin e Dytë (II) të Zgjedhjeve të Jashtëzakonshme në Komunën e Istogut, që parashihet në bazë të dispozitave ligjore të neneve 40.1 dhe 119.2 të LZP-së, si dhe në bazë të nenit 6.6 të Rregullës Zgjedhor nr. 12/2009, në këtë institucion.

Parashtruesi i ankesës vërteton se PDK nuk e ka sjell Raportin Financiar, që ka qenë deri më 17.06.2010 për Rundin e Dytë (II) të Zgjedhjeve të Jashtëzakonshme në Komunën e Istogut.

F A K T E T

Më 23.06.2010, KZAP-i i ka dërguar subjektin politik PDK, një kopje të ankesës së ZRPPC-së dhe i ka ofruar mundësi që të përgjigjet deri më 25.06.2010, në përfundim të orarit të punës së KZAP-it. Sekretariati i KZAP-it nuk ka pranuar ndonjë përgjigje në ankesë nga subjekti politik PDK deri në kohen e caktuar.

A N A L I Z Ë

Juridiksioni i KZAP-it për shqyrtimin e ankesës buron nga kompetencat e dhëna nga Kuvendi i Republikës së Kosovës në Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës – LZP (Ligji nr – 03/073) dhe Ligjin për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës (Ligji nr 03/L-072).

Neni 40 paragrafi 1 (Kërkesat për Deklarim Financiar) të LZP-së, parasheh se:

Çdo subjekt politik i certifikuar për pjesëmarrje në zgjedhje, dorëzon Raportet e Deklarimit Financiar të Fushatës së Subjektit, duke i përfshirë të gjitha degët dhe pjesët përbërëse të tij, për periudhën që fillon nëntëdhjetë (90) ditë para zgjedhjeve dhe me mbarim në ditën e zgjedhjeve. Raporti i Publikimit Financiar për Fushatën dorëzohet jo më vonë se dyzetë e pesë (45) ditë kalendarike pas ditës së zgjedhjeve.

Në këtë kontekst, subjekti politik PDK ka qenë i detyruar në bazë të këtij ligji që të dërgoj Raportin Financiar për Raundin e Dytë (II) të Zgjedhjeve të Jashtëzakonshme në Komunën e Istogut, jo më vonë se 17.06.2010 – gjë që nuk ka ndodhur, prandaj pretendimet e ankimore janë te bazuara.

Neni 120 paragrafi 1 pika c (Përmirësimet dhe sanksionet ndaj shkeljeve) të LZP-së, parasheh se:

Në rast se KZAP-i përcakton se ka ndodhur shkelje e këtij ligji ose e Rregullave Zgjedhore të KQZ-së mund të vendos një gjobë ndaj një subjekti politik ose një organizatë vëzhguese në një vlerë deri në dyqind mijë euro (€ 200,000).

Duke vendosur për gjobën që është përcaktuar në këtë lëndë, KZAP-i ka marrë si rrethanë posaçërisht rënduese faktin se subjekti politik PDK, tri herë radhazi ka bërë shkelje të afateve ligjore sa i përket Raportit Financiar gjatë procesit zgjedhor 2009/2010, dhe asnjëherë nuk është përgjigjur për shkeljet e bëra në shkresat ofruara nga ana e KZAP-it, po ashtu KZAP-i ka marrë parasysh edhe faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, prandaj ai do të duhet të ishte i njoftuar me obligimet dhe përgjegjësitë e tij gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë; dhe
- Masat, nëse ka pasur fare të tilla, të cilat janë ndërmarrë apo miratuar nga subjekti politik për të parandaluar shkelje të ligjeve përkatëse zgjedhore në Kosovë;
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Konsoliduar të Republikës së Kosovës për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura me fushatën zgjedhore të tij;
- Ndonjë rrethanë tjetër lehtësuese ose rënduese.

Për këto arsye, bazuar në dispozitën e nenit 115.1 të LZP, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës në Prishtinë

A nr. 188/2010 më datën 16 Korrik 2010.

Kryesuesi i Panelit

Muharrem Shala

